

Vendim nr. 20 datë 05.02.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 28 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: X.Y.

OBJEKTI: Pezullimi i zbatimit të vendimeve të datës 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kontrollin e banesës, paraqitjen e të dhënave elektronike të kërkuarit, kontrollin personal të tij dhe specifikisht organet proceduese të:

- pezullojnë veprimet e nxjerrjes, përpunimit të të dhënave nga pajisjet e sekuestruara kompjuterike e telefonike apo disqe, të pritshëm për t'u kryer, si dhe të sigurojnë çdo pajisje të sekuestruar me vulë në praninë e kërkuarit dhe avokatit të zgjedhur prej tij;
- vlerësojnë mundësitë e tjera efektive të hetimit para se të vlerësohet që aksesimi i të dhënave të kërkuarit është rruga e vetme efektive për të hetuar ngjarjen;
- mundësojnë që kërkuari dhe avokati i zgjedhur prej tij të jenë të pranishëm përpara çdo aksesimi, nxjerrjeje dhe përpunimi të të dhënave, me qëllim që të miratohet mënyra e aksesimit, nxjerrjes dhe përpunimit të të dhënave;
- marrin masa që çdo procedurë qerimi/shoshitjeje e të dhënave të mos bëhet duke përdorur fjalë kyçe të pakomunikuara më herët kërkuarit dhe të miratuara nga gjykata, me qëllim mospërfshirjen e termave të gjerë të

kërkimit kompjuterik që mund të përfshijnë si rezultat evidentimin e shumë dokumenteve elektronike njëherësh;

- ndalojnë aksesin dhe kopjimin e çdo dokumenti apo të dhëne elektronike jorelevante pa respektuar të gjithë hapat e mësipërm.

Shfuqizimi i vendimeve të datës 13.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kontrollin e banesës, paraqitjen e të dhënave elektronike dhe kontrollin personal të kërkuesit, si dhe çdo akti procedural të prodhuar si pasojë e zbatimit të këtyre vendimeve, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 22, 36, 37, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) në kuadër të një procedimi ka hetuar kryerjen e disa vepra penale nga një grup i strukturuar kriminal. Mbi bazën e materialit referues të hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit (*BKH*), në datën 12.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” dhe “Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 295/a, paragrafi

i tretë dhe 313/b, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*). Me vendim të së njëjtës datë, këto dy procedime penale janë bashkuar, për t'u hetuar në një të vetëm.

2. Prokuroria e Posaçme ka referuar se në faqen e internetit të një media audiovizive është publikuar një artikull që sipas referencave është shkruar nga kërkuesi X.Y. Sipas Prokurorisë së Posaçme, bisedat e bëra publike në media nuk janë dokumentuar ende në aktet procedurale nga ana e saj në kuadër të procedimit penal.

3. Në datën 13.12.2023 kërkuesi është thirrur në Prokurorinë e Posaçme për t'u pyetur në cilësinë e personit në dijeni të fakteve, për mënyrën se si është vënë në dijeni të këtyre akteve hetimore që përbëjnë sekret hetimor, zbulimi i të cilave ndaj të tretëve përmes publikimit është i palejueshëm me ligj. Në parashikim të neneve 202, 202/a, 203, 205, pika 4, 206, 207 e 208 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), Prokuroria e Posaçme ka kërkuar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO*) lejimin e kontrollit në vendin e punës dhe banesën e kërkuesit, me qëllim për të kërkuar, gjetur, marrë e sekuestruar sende dhe prova materiale që lidhen me veprën penale; lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në vendin e punës të kërkuesit, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik; lejimin e kontrollit personal të kërkuesit për të këqyrur, gjetur e sekuestruar sende e prova materiale që lidhen me veprën penale (kryesisht aparat/celular që disponon).

4. Me vendimin e datës 13.12.2023, GJKKO-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe lejimin e kontrollit në vendin e punës dhe banesën e kërkuesit, me qëllim për të kërkuar, gjetur, marrë e sekuestruar sende dhe prova që lidhen me veprën penale.

5. Edhe me një vendim tjetër të datës 13.12.2023, GJKKO-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik në vendin e punës dhe banesën e kërkuesit, duke kërkuar, hyrë, nxjerrë dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik. Kurse me vendimin tjetër të datës 13.12.2023, GJKKO-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, lejimin e kontrollit personal të kërkuesit, me qëllim gjetjen e sendeve ose provave materiale që lidhen me veprën penale.

6. Në datën 22.12.2023 kërkuesi X.Y. i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara të GJKKO-së.

7. Në datën 08.01.2024 kërkuesi ka paraqitur një kërkesë të nënshkruar nga përfaqësuesi i tij për heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës, duke kërkuar që Gjykata të pushojë

gjykimin e kërkesës së tij në këtë fazë dhe ai të ruajë të drejtën për të paraqitur një kërkesë në të ardhmen.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkueti**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

8.1. *Lirinë e shprehjes*, të parashikuar në nenin 22 të Kushtetutës në tejkallim të kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 10, pika 2, të KEDNJ-së. Qëllimi në këtë rast nuk është legjitimim, sepse nuk është parashtruar një situatë ku tregimi i burimit është e vetmja mënyrë për të provuar veprën penale. Po kështu, nuk është ushtruar një balancë proporcionaliteti për këtë ndërhyrje. GJKKO-ja ka qenë para rastit të parashikuar në nenin 295/a të KP-së dhe kërkueti nuk është subjekt i kësaj vepre, por vetëm një person që ka dijeni për rrethanat. Gjykata ka autorizuar aksesin e të gjitha të dhënave, pavarësisht se sa kanë ato lidhje me hetimin, duke ekzistuar rreziku që organi i akuzës të ketë akses në aspekte të tjera të punës së kërkuetit dhe medias pa asnjë lidhje me çështjen.

8.2. Sipas GJEDNJ-së sekuestrimi i pajisjeve mund të bëhet vetëm kur rrethanat e paraqesin këtë veprim të domosdoshëm dhe rrugë të vetme të mbërritjes tek e vërteta, kur të gjitha mundësitë e tjera janë ezauruar ose nuk janë efektive. Sekuestrimi duhet të jetë proporcional dhe është *extrema ratio*. Megjithatë, kjo analizë duhej të ishte bërë nga gjykata e posaçme, e cila ka shpërfillur edhe vendimin njësuës të Gjykatës së Lartë të vitit 2021. Gjykata ka vënë në rrezik jo vetëm marrëdhëniet me burimet e kërkuetit, por edhe sinjalizuesit e mundshëm që punojnë në institucionet shtetërore. Sekuestrimi i pajisjeve rrezikon edhe sekretet profesionale dhe personale të kërkuetit, si dhe mosfunksionimin e tij si të tillë.

8.3. Kërkueti nuk është thirrur nga gjykata në seancën e vlerësimit të kërkesës së prokurorisë për sekuestrim të pajisjeve. Neni 159, pika 3, i KPP-së parashikon që gjykata është organi i caktuar me ligj për të treguar burimin e informacionit, që në rastin konkret nuk është kryer, ndërkohë që kërkesa e prokurorëve për të treguar burimin është jashtë kompetencës së tyre. Gjykata duhej të thërriste kërkuetin në seancë dhe të vlerësonte nëse të dhënat ishin të domosdoshme dhe nuk mund të siguroheshin në mënyra të tjera. Nëse kërkueti nuk thirret në

seancë dhe vendimi merret *ex parte*, ankimi në një gjykatë më të lartë nuk është efektiv, pasi nuk mund të rivendosen në vend pasojat negative dhe të pariparueshme që sjell ekzekutimi i vendimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

9. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve të GJKKO-së të datës 13.12.2023, me të cilat është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe lejimi i kontrollit të vendit të punës dhe banesës së tij, si dhe i të dhënave kompjuterike dhe i kontrollit personal, duke pretenduar se ato janë marrë në kundërshtim dhe në cenim të të drejtave të tij kushtetuese.

10. Ankimi kushtetues është paraqitur nga kërkuesi në datën 22.12.2023, i nënshkruar prej tij dhe përfaqësuesit me prokurë, kurse në datën 08.01.2024 në Gjykatë është paraqitur një kërkesë e nënshkruar nga përfaqësuesi i kërkuesit për heqjen dorë nga shqyrtimi i kërkesës. Në kërkesë është kërkuar që Gjykata të pushojë gjykimin e kërkesës së tij në këtë fazë dhe ai të ruajë të drejtën për të paraqitur një kërkesë në të ardhmen nëse gjykatat e të gjitha niveleve nuk arrijnë të adresojnë shkeljen e pretenduar, ose të vendosë mospranimin e kërkesës nëse vlerëson *ex officio* që shqyrtimi i saj paraqet interes publik.

11. Kolegji, fillimisht, duke iu referuar përmbajtjes së prokurës në drejtim të tagrave të përfaqësuesit ligjor, konstaton se kërkuesi i ka dhënë avokatit të drejtën të hartojë dhe nënshkruajë çdo lloj kërkesë, drejtuar çdo shkallë gjykimi, të paraqesë edhe kërkesë ose shpjegime në Gjykatë, si edhe të heqë dorë nga gjykimi i ankimeve dhe kërkesës në këtë Gjykatë.

12. Në nenin 31/b të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet: “1. Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjyimit të çështjes. 2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.”. Ndërsa në pikën 2 të nenit 43/b të po këtij ligji parashikohet: “Kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa.”. Referuar këtyre dispozitave, nën dritën e parimit të disponibilitetit të ankimit kushtetues, akti i heqjes dorë passjell, si rregull, pushimin e shqyrtimit të çështjes, me përjashtim të rastit kur Gjykata vlerëson se shqyrtimi i saj mbart interes publik. Kolegji vëren se kërkesa për heqjen dorë është depozituar nga kërkuesi në datën 08.01.2024, pas pothuajse dy javësh nga paraqitja e ankimit kushtetues dhe përpara

se Kolegji të vlerësonte kriteret paraprake të pranueshmërisë së tij, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000. Kjo rrethanë e bën të pamundur për Kolegjin verifikimin dhe vlerësimin e mëtejshëm nëse çështja konkrete përbën rast përjashtimor, në kuptimin e ekzistencës së interesit publik, arsye për të cilën Gjykata mund të vendosë mospranimin e heqjes dorë nga ankimi dhe vijimin e shqyrtimit të tij.

13. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesi i pajisur me tagra.

14. Kolegji vëren, gjithashtu, se në kërkesë është pretenduar edhe ruajtja anonimatit të kërkuarit, nisur nga natyra sensitive e çështjes, si dhe nga fakti se vendimet objekt kërkesë përmbajnë, në mënyrë të shprehur, edhe detyrimin e mospublikimit të tyre. Sipas tij, duke qenë se vendimet e Gjykatës publikohen në faqen e internetit, është e nevojshme të ruhen të dhënat, përfshirë ato të kërkuarit në këtë fazë të procedimit.

15. Sipas nenit 13, pika 4, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, në rast se palët nuk dëshirojnë që të dhënat e tyre të bëhen publike, duhet të paraqesin një kërkesë që tregon arsyet për përjashtimin nga ky rregull, të dhënat që nuk duhet të bëhen publike, si dhe mënyrën e anonimizimit të këtyre të dhënave. Kolegji vëren se sipas nenit 103, pikat 1 dhe 2, të KPP-së ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv, si dhe i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Mbi bazën e kësaj dispozite GJKKO-ja ka disponuar në dispozitivin e vendimeve ndalimin e publikimit të tyre. Po kështu, rezulton se procedimet penale në kuadër të të cilave janë dhënë këto vendime kanë të bëjnë edhe me akte ose të dhëna hetimore sekrete dhe publikimin e këtyre të dhënave me karakter të klasifikuar. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh sa më sipërm edhe se faktet e këtij ankimi kushtetues lidhen me të dhëna personale të kërkuarit, të cilat mbrohen nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Kolegji çmon se vendimi duhet publikuar i anonimizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31/b, pika 1 dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Pushimin e gjykimit të çështjes.

Anonimizimin e të dhënave personale të kërkesit për efekt publikimi të vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.